

Parandalimi i sëmundjeve të viçat fillon që me dhënien e kulloshtrës.

*Kujdesi i duhur ndaj viçave, që në lindje, është hapi i parë për një mbarështim të suksesshëm.*

Veterineri Mag. Kritzinger nga SCHAUMANN Austri thekson sidomos dhënien e qumështit në kohën e duhur për një fillim të duhur në jetë. Brenda 2 orëve duhet që viçat të konsumojnë rreth 3-4 litra qumësht. Cilësinë e qumështit nuk e dallon nga ngjyra, por nga qëndrueshmëria dhe jo çdo lopë ka gjithnjë një cilësi të mirë të qumështit. Për këtë duhet gjithmonë paraprakisht të ketë rezervë nga lopët e vjetra. Diarreja, sipas Kritzinger, është ndër problemet e para madhore tek viçat. Identifikimi në kohë, infuzioni i shpejtë me elektrolite dhe eliminimi i qumështit, janë masa të rëndësishme për ndalimin e diarresë tek viçat. Ai sugjeron planin e mëposhtëm të ushqyerjes (shiko tabelën), i rekomandueshëm për viçat me diarre.

Diarreja tek viçat e vjetër lidhet me faktorë patogjene specifik, si koksidia. Këtu është shumë e rëndësishme arka e desinfektimit. Për të luftuar koksidiën ekzistojnë mjete të posaçme desinfektuese.

### **Racioni me lëndët e thata për viçat**

Këshilltari i SCHAUMANN dhe Austria Prämix shpk, Ing. Franz Riegler tregon mbi eksperiencën e tij në përdorimin e lëndës së thatë për viçat.



**Plani për viçat me diarre**

Në mëngjes 1,5 – 2 litër qumësht

Paradite 1 - 1,5 litër pije me përbërje elektrolitesh

Në drekë 1,5 – 2 litër qumësht

Pasdite 1 - 1,5 litër pije me përbërje elektrolitesh

Në darkë 1,5 - 2 litër qumësht

Në darkë vonë 1 - 1,5 litër pije me përbërje elektrolitesh

### **MOS PËRZIENI APO HOLLONI QUMËSHTIN!**

Zakonisht zhvillimi në kohën e duhur i rumenit është treguesi më i mirë për majmëri dhe mbarështim. Nëpërmjet përdorimit të koncentratit të viçave ose TMR e viçave me 25% përmbajtje bar nxitet pozitivisht zhvillimi i rumenit. Franz Riegler parashtrroi avantazhet e Kälber-TMR në fermën e tij, përkatësisht procesin konkret të përzierjes, magazinimit dhe ushqyerjes. Me një përzierje prej 800 kg sanë dhe 40 kg melasë, ai mund të ushqejë viçat e tij për 2 muaj. Ai e ka përdorur që prej gjashtë muajsh këtë përzierje dhe është shumë i kënaqur me zhvillimin dhe rendimentin e viçave.

## Por sa koncentrat i nevojiten një lope?

Koncentrat: Plotësimi i nevojave me koncentrat në çdo fazë të laktacionit është një nga kushtet bazë të ushqyerjes.

Furnizimi i gabuar me koncentrat në fazën e tranzitit mund të çojë në ketozë, acidozë, mungesë vitaminash dhe në shumë probleme të tjera pasuese. Pak para dhe pas pjelljes rumeni nuk duhet të ngarkohet. Kështu menjëherë pas pjelljes duhet të ushqehet me koncentrat, që të plotësohet sa më mirë kërkesa për lëndë ushqyese pas pjelljes.

**Periodha e tharjes:** Periodha e tharjes ndahet në 2 faza:

Në pesë javët e para duhet të parandalohet dhjamosja.

Në 3 javët në vazhdim lopa duhet të mësohet me racionin që përdoret për lopët me rendiment të lartë. Për shkak të zvogëlimit të vëllimit të rumenit lopa nuk dhjamoset më me racionet e theksuara koncentratesh.

**Udhëzimet:** Të paktën 14 ditë, më mirë akoma, 20 ditë përpara datës së llogaritur për pjellje të fillohet me koncentrat, rritje e ngadaltë me një maksimum prej një të tretën e kilogramit (300 gr) në ditë.

7-10 ditë përpara pjelljes lopa duhet të marrë 2 - 2,5 kg koncentrat. Mënyra e dhënies së koncentratit: koncentrat i balancuar, si grupi i lopëve me rendiment të lartë.

Por kini kujdes! Burime kalciumi si tulli i panxharit, bliri dhe përzierjet minerale duhen shmangur për shkak të rrezikut të vetë përmbajtjes së lartë të kalciumit që përmban qumështi.

**Pas pjelljes** lopa duhet nxitur që të ushqehet me foragjere. Kjo arrihet nëpërmjet ushqyerjes me sasi të vogla koncentratesh të përfshira në ushqimin bazë. Sasia e koncentratit nuk duhet rritur në ditët e para. Vetëm pas ditës së tretë pas pjelljes fillohet të rritet sasia e koncentratit. Udhëzimet për rritjen e përmbajtjes së koncentratit vlejnjë si më lartë:

Një rritje maksimale prej një të tretën e kilogramit (300 gr) në ditë, korrespondon me 2 kilogram për javë.

Këshillë: Gjatë ushqyerjes, ushqimi bazë duhet mbajtur nën vëzhgim nëpërmjet rumenit (gropa e urisë majtas) dhe zorrës (djathtas).

